

Pranuar - Prinjeno MeDana	04-08-2020		
Nr. i organit Org. broj	Numri/Drej	Emri/Poste Prilog	Vlera Vendos
	02-370/03-768		

	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Vitisë Opstina Vitina-Municipality of Vitina</p>	
---	---	---

ZYRA E PROKURIMIT

KONTRATË PËR FURNIZIM

Nr1 i prokurimit	657-20-2781-1-2-1
Nr i brendshëm	VI657-20-002-121

TITULLI I KONTRATËS : Furnizim me material të imët dhe paisje teknike për nevojat e të gjitha njësive shpenzuese

E LIDHUR NË MES TË

Operatori ekonomik	Autoriteti kontraktues
<p>N.P.SH. " ONI DESIGN ", PRISHTINË,</p> <p style="text-align: right;">Përfaqësuar nga:</p>	<p>KOMUNA E VITISË</p> <p style="text-align: right;">Përfaqësuar nga:</p>
<p>Ilir Sadiku , drejtor</p>	<p>Fadil ABAZI, menaxher i prokurimit</p>
<p> v.v</p> <p></p>	<p> v.v</p> <p></p>

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

KOMUNA E VITISË, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në një të anë; dhe

N.P.SH. " **ONI DESIGN** ", PRISHTINË (në vazhdim "operatori ekonomik" në anë të tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara më poshtë: **Furnizim me material të imët dhe pajisje teknike për nevojat e të gjitha njësive shpenzuese, numer.prok: 657-20-2781-1-2-1**

Neni 1: **Lënda** Lënda e kontratës është furnizim duhet të jete Furnizuesi i furnizimeve në vijim: **Furnizim me material të imët dhe pajisje teknike për nevojat e të gjitha njësive shpenzuese**

Neni 2: **Çmimi**

2.1 Çmimi i Planifikuar i kontratës është: **19 551.29 €**

Me fjalë: Nëntëmbëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e një Euro / 29 centi

Kontrata fillon së implementuari nga dita nënshkrimit 04.08.2020 dhe përfundon me 03.08.2021,

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Furnizimit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 **Kushtet e dërgesës**

3.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

3.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë: **Komuna e Vitise**

Neni 4: **Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër

Neni 5 **Komunikimet**

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të furnizimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

Titulli: Furnizim me material të imët dhe pajisje teknike për nevojat e të gjitha njësive shpenzuese Nr. Prokurimit-brendshem: VI657-20-002-121

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në **gjuhën shqipe** në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Furnizimeve.

Për Ofruesin e Shërbimeve

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Ilir Sadiku	Emri:	Fadil ABAZI
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Menxher i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	04.08.2020	Data:	04/08/2020
Vula:		Vula:	

PJESA II E KONTRATES

KUSHTETË PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "**Kontratë**" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "**Produktet**" përkufizohen si të mira materiale që kanë vlerë ekonomike, duke përfshirë por pa u kufizuar në mallrat, artikujt, lëndët e para, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë të lëngshme ose të gazshme.

1.3 "**Autoriteti Kontraktues**" do të thotë organizata e blerjes së mallrave, siç është e quajtur Fletën mbi të Dhënat e Tenderit.

1.4 "**Furnizues**" do të thotë një person fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon mallra që janë objekt i kësaj kontrate.

1.5 "**Palë(t)**" do të thotë nënshkruesit e kontratës.

1.6 "**Inkotermet**" do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë mënyrën, kostot dhe rreziqet që lidhen me transferimin e produkteve nga furnizuesi tek autoriteti kontraktues.

1.7 "**Furnizim**" do të thotë dorëzim i produkteve me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

1.8 “Çmimi i kontratës” do të thotë çmimi që i paguhet furnizuesit siç specifikohet në formularin e kontratës, në përputhje me shtesa të tilla dhe rregullimet ose heqjet, si mund të bëhet në bazë të kontratës.

1.9 “Shërbimet pas shitjes” do të thotë shërbimet ndihmëse, si: instalimi, mirëmbajtja, riparimi i furnizimeve, sigurimi i pjesëve rezervë që i prodhon apo i distribuon furnizuesi dhe/ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimet e produkteve.

1.10 “KPK” do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.11 “KVK” do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Furnizuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Furnizuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Furnizuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Furnizuesit siguruesve të Furnizuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Furnizuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Furnizuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Furnizuesi nuk nënkontraktin pa autorizim me shkrim nga Autoriteti kontraktues. Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njuh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve.

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Furnizuesit pa pagesë atëherë kur është e nevojshme, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Furnizuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato mund të gjenden. Pas lëshimit të certifikatës së garancisë, ose pas pranimit final të saj, Furnizuesi i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Furnizuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Furnizuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Titulli: Furnizim me material të imët dhe paisje teknike për nevojat e të gjitha njësive shpenzuese Nr. Prokurimit-brendshem: VI657-20-002-121

Neni 6 Ndhimja lidhur me rregulloret vendore

6.1 Furnizuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te furnizuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar nga Furnizuesi me shpenzime të Furnizuesit.

6.2 Nëse është e nevojshme, Furnizuesi do ta lajmërojë me kohë Autoritetin kontraktues për të dhënat mbi furnizimet ashtu që Autoriteti kontraktues të mund të marrë lejet e kërkuara ose licencat e importit.

6.3 Autoriteti kontraktues do të vendosë që të marrë lejet e kërkuara apo licencat e importit brenda një periudhe të arsyeshme, duke marrë parasysh datat e realizimit të kontratës.

Neni 7 Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit

7.1 Furnizuesi duhet ta realizojë kontratën me kujdesin dhe syçeltësinë e duhur duke përfshirë, aty ku është specifikuar, dizajnin, prodhimin, dorëzimin e furnizimit dhe kryerjen e punëve të tjera përfshirë kompensimin për ndonjë defekt në furnizime.

7.2 Furnizuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Furnizuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

7.3 Furnizuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

7.4 Furnizuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpallë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

7.5 Nëse Furnizuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

Neni 8 Prejardhja

8.1 Furnizuesi do të paraqesë një certifikatë zyrtare të prejardhjes në momentin e pranimit të perkohshëm. Nëse ky obligim nuk plotësohet, kjo do të çojë në ndërprerje të kontratës, me paralajmërim zyrtar.

Neni 9 Siguria e ekzekutimit

9.1 Furnizuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizojë Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Furnizuesit.

9.2 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

9.3 Përveç asaj pjese të specifikuar në KVK lidhur me shërbimin pas-shitjes, siguria e ekzekutimit do të lëshohet brenda 30 ditësh nga lëshimi i certifikatës së perkohshme të pranimit.

Neni 10 Sigurimi

10.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë të siguruar plotësisht me një valute lirisht të konvertueshme kundër humbjes ose dëmtimit të rastësishëm të prodhoj ose blejë, transportoj, ruaj dhe shpërndaj në mënyrën e specifikuar në KVK.

10.2 Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit të Furnizuesit sipas Nenit 10.1, Furnizuesi do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat nga palët e treta për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ana e Furnizuesit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre.

Neni 11 Programi i realizimit

11.1 Nëse kërkohet në KVK, Furnizuesi do të dorëzojë një program të realizimit të kontratës që do të aprovohet nga autoriteti kontraktues. Ky program do të përmbajë së paku këto:

- i) rendin sipas të cilit Furnizuesi propozon të realizohet kontrata, duke përfshirë dizajnin, prodhimin, dorëzimin në vend të pranimit, instalimin, testimin dhe komisionimin; dhe
- ii) të dhëna dhe informata të tjera të cilat mund t'i kërkojë me arsye autoriteti kontraktues.

11.2 KVK do të saktësojnë limitin kohor brenda të cilit programi i realizimit duhet t'i dorëzohet për aprovim autoriteti kontraktues dhe afatin e fundit për aprovimin e Autoritetit Kontraktues. Aprovimi i programit nga autoriteti kontraktues nuk e liron Furnizuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

11.3 Nëse Autoriteti Kontraktues nuk arrin të njoftoj vendimin e tij të aprovimit i përmendur në Nenin 11.2 brenda afateve të përmendura në kontratë programi i tillë i realizimit duhet të konsiderohet i aprovuar me kalimin e afateve. Në qoftë se nuk ka afat të caktuar, ato do të konsiderohet të aprovuara 30 dite pas pranimit.

11.4 Asnjë ndryshim material në program nuk mund të bëhet pa aprovimin e autoritetit kontraktues. Megjithatë, nëse progresi i realizimit të kontratës nuk bëhet sipas programit, autoriteti kontraktues mund ta udhëzojë Furnizuesin që ta ripunojë programin dhe ta dorëzojë programin e ripunuar për aprovim të ai.

Neni 12 Marrëveshjet tatimore dhe doganore

12.1 Duke iu nënshtruar dispozitave të tjera të përcaktuara në KVK, Furnizuesi do të jetë plotësisht përgjegjës për pagesën e të gjitha taksave, detyrimeve të pullës, taksat e licencave, tarifave doganore dhe taksat tjera që lindin apo imponohen deri në dorëzimin e Mallrave të kontraktuara në vendin e dorëzimit, siç është përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 13 Patentat dhe licencat

13.1 Përveç në rastet kur është paraparë ndryshe në KVK, Furnizuesi do ta sigurojë autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat që janë rezultat i përdorimit të patentave, licencave, skicave, modeleve ose markave apo emrave tregtarë siç është specifikuar në kontratë, përveç nëse shkelja e tillë është rezultat i veprimit sipas dizajnit ose specifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktues.

Neni 14 Periudha e ekzekutimit të detyrave

14.1 Periudha e ekzekutimit të detyrave do të fillojë në datën e fiksuar në pajtim me Nenin 2, pa paragjykim ndaj zgjatjeve të periudhës të cilat mund të lejohen sipas Nenit 15.

14.2 Përveç kur palët pajtohen ndryshe, realizimi i kontratës duhet të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Furnizuesi ka të drejtë të mos e realizojë kontratën dhe të marrë përfundimin e saj apo kompensimin për dëmin që ka pësuar. Furnizuesit do ta humb këtë të drejtë përveç nëse ai e ushtron atë brenda 30 ditëve nga data e skadimit të periudhës 90 ditësh.

14.3 Nëse mundësohen periudhat e ndara të realizimit për sasi të ndara, këto periudha nuk do të mbledhen në rastet kur një Furnizuesi i jep më shumë se një sasi.

Neni 15 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

15.1 Furnizues mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritët se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues porosit furnizime ekstra ose plotësuese;
- b) Kushte të jashtëzakonshme klimatike në vendin e autoritetit kontraktues kanë prekur instalimin apo dorëzimin e furnizimeve;
- c) Pengesa apo kushte fizike që mund të ndikojnë në dorëzimin e furnizimeve, të cilat nuk kanë mundur të parashihen në mënyrë të mjaftueshme nga një furnizues kompetent;
- d) Urdhra administrative që kanë ndikuar në datën e realizimit, përveç atyre që janë shkaktuar prej gabimit të furnizuesit;
- e) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- f) Të gjitha suspendimet e dorëzimit dhe/ose instalimit të furnizimeve që nuk janë për shkak të gabimit të

Titulli: Furnizim me material të imët dhe pajse teknike për nevojat e të gjitha njësisve shpenzuese Nr. Prokurimit-brendshëm: VI657-20-002-121

Furnizuesit;

g) Forca madhore;

h) Shkaqe tjera që janë përmendur në këto Kushte të përgjithshme dhe të cilat nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit.

15.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Furnizues duhet ta lajmërojë autoritetin kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Furnizuesit dhe autoritetit kontraktues, brenda 30 ditësh i jep autoritetit kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

15.3 Brenda 30 ditësh, me njoftim me shkrim për furnizuesin, autoriteti kontraktues do ta lejojë këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Furnizuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 16 Vonesat e ekzekutimit

16.1 Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

16.2 Nëse mosdorëzimi i mallrave parandalon përdorimin e zakonshëm të furnizimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 16.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të kontratës

16.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së kontratës ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Furnizuesin:

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të furnizimeve. Furnizuesi nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

Neni 17 Suspendimi

17.1 Autoriteti kontraktues mundet, me urdhër administrativ, në çfarëdo kohe ta udhëzojë Furnizuesin që të pezullojë:

- a. prodhimin e furnizimeve;
- b. dorëzimin e furnizimeve në vendin e pranimit në kohën e specifikuar për dorëzim në programin e realizimit ose, nëse nuk është specifikuar koha, në kohën kur ato duhet të dorëzohen; ose
- c. instalimin e furnizimeve që janë dorëzuar në vendin e pranimit.

17.2 Gjatë pezullimit, Furnizuesi do të mbrojnë dhe sigurojnë furnizimet e vendosura në depon e Furnizuesit ose në ndonjë vend tjetër, nga përkeqësimi, humbja apo dëmtimi për aq sa të jetë e mundur dhe sa është kërkuar nga autoriteti kontraktues, edhe nëse furnizimet janë dorëzuar në vendin e pranimit në pajtim me kontratën, por instalimi i tyre është pezulluar nga autoriteti kontraktues.

17.3 Shpenzimet plotësuese që janë shfaqur në lidhje me këto masa mbrojtëse do t'i shtohen çmimit të kontratës. Furnizuesi nuk do të marrë pagesë të shpenzimeve plotësuese nëse pezullimi është:

- a) Zgjidhur në mënyrë të ndryshme në kontratë; ose
- b) është i nevojshëm për arsye të kushteve të zakonshme klimatike në vendin e pranimit;
- c) është i nevojshëm për shkak të ndonjë gabimi të Furnizuesit; ose
- d) është i nevojshëm për siguri të ekzekutimit të mirë të kontratës ose të ndonjë pjese të saj përderisa nevoja e tillë nuk shkaktohet nga ndonjë veprim apo gabim nga autoriteti kontraktues.

17.4 Furnizues nuk do të ketë të drejtë për shtesa në çmimin e kontratës përveç nëse ai e lajmëron autoritetin kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit për të pezulluar progresin e dorëzimit se ka për qëllim të bëjë

Titulli: Furnizim me material të imët dhe paisje teknike për nevojat e të gjitha njësisve shpenzuese Nr. Prokurimit-brendshëm: V1657-20-002-121

Neni 18

Cilësia e furnizimeve

18.1 Furnizimet duhet t'i plotësojnë specifikimet teknike të paraqitura në kontratë në të gjitha aspektet dhe të jenë konform në të gjitha aspektet me skicat, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë, të cilat duhet të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë periudhës së realizimit të kontratës.

18.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare të parapara në KVK duhet të bëhen me kërkesë të dërguar nga furnizuesi i për autoritetin kontraktues. Në kërkesë do të saktësohen materialet, artikujt dhe mostrat e dorëzuara për këtë pranim sipas kontratës dhe të tregojë numrin e sasisë dhe vendin ku do të bëhet pranimi në mënyrën e duhur. Materialet, artikujt dhe mostrat e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në furnizime.

18.3 Edhe nëse materialet apo artikujt që do të inkorporohen në furnizime ose në prodhim të komponentëve që do të furnizohen janë pranuar teknikisht në këtë mënyrë, ato prapë mund të refuzohen nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime, dhe në këtë rast ato duhet të ndërrohen menjëherë nga furnizuesi. Furnizuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikuj do të pranohen për inkorporim në furnizime vetëm nëse janë riparuar dhe janë përmirësuar në atë mënyrë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

Neni 19

Inspektimi dhe testimi

19.1 Furnizues do të sigurojë që furnizimet të dorëzohen në vendin e pranimi me kohë që t'i mundësohet autoritetit kontraktues të vazhdojë me pranimin e furnizimeve. Furnizuesi konsiderohet se i ka paraparë plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe atij nuk do t'i lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë.

19.2 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vendin e pranimi apo në vendet që janë specifikuar në KVK.

19.3 Për qëllime të testimeve dhe inspektimeve të tilla, Furnizues do të:

- a) I japë autoritetit kontraktues, përkohësisht dhe pa pagesë, ndihmë, mostra ose pjesë për testim, makina, pajisje, vegla, punë, materiale, skica dhe të dhëna të prodhimit që zakonisht kërkohen për inspektim dhe testim;
- b) Të merret vesh me autoritetin kontraktues për vendin dhe kohën e testimeve;
- c) T'i japë autoritetit kontraktues qasje në çfarëdo kohe të arsyeshme në vendin ku do të realizohen testimet.

19.4 Nëse përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues nuk është prezent në datën e vendosur për testim, furnizuesi mundet që, përveç nëse ka marrë udhëzim tjetër nga autoriteti kontraktues, të vazhdojë testimin, i cili do të konsiderohet se është bërë në prezencën e autoritetit kontraktues. Furnizuesi menjëherë do t'i dërgojë kopjet e certifikuar si duhet të rezultateve të testit të Autoritetit kontraktues, nëse nuk ka qenë prezent gjatë testit, do t'i pranojë rezultatet e testit.

Neni 20 Parimet të përgjithshme të pagesave

20.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i bëhet Furnizues sipas kësaj Kontrate do të specifikohen në KVK.

20.2 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Furnizues do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Furnizuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

20.3 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

20.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Furnizuesin që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i

Titulli: Furnizim me material të imët dhe pajisje teknike për nevojat e të gjitha njësive shpenzuese Nr. Prokurimit-brendshëm: V1657-20-002-121

menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Furnizues do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

20.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 20.3, Furnizues mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga institucioni lëshues i Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

20.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 20.3 do t'i japin të drejtë Furnizuesit që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

Neni 21 Dorëzimi

21.1 Furnizuesi duhet t'i dorëzojë furnizimet në pajtim me kushtet e kontratës. Furnizimet do të jenë në përgjegjësi të Furnizuesit deri në pranimin e tyre të përkohshëm.

21.2 Furnizuesi do t'i paketojë furnizimet ashtu siç kërkohet për të parandaluar dëmtimin apo keqësimin e gjendjes së tyre gjatë transportit deri në destinacionin e tyre, siç është dhënë në kontratë. Paketimi duhet të jetë i mjaftueshëm për të përballuar pa kufizime, bartjen e ashpër, ekspozimin në temperatura ekstreme, kripën dhe rëniet gjatë tranzitit dhe mbajtjen në ambient të hapur. Madhësia e paketimit dhe pesha duhet t'i përshtaten, nëse është e mundur, largësisë së destinacionit përfundimtar të furnizimeve, dhe mundësisë së mungesës së pajisjeve për bartje të rëndë në të gjitha pikat gjatë transitit.

21.3 Paketimi, shënimi dhe dokumentacioni brenda dhe jashtë pakove duhet të jenë në pajtim me kërkesat e dhëna në mënyrë të hapur në KVK, dhe i nënshtrohen ndryshimeve që mund të urdhërohen më vonë nga autoriteti kontraktues.

21.4 Asnjë furnizim nuk do të transportohet as të dorëzohet në vendin e pranimit derisa furnizuesi të ketë pranuar urdhrin e dorëzimit nga autoriteti kontraktues. Furnizuesi do të jetë përgjegjës për dorëzim në vendin e pranimit të të gjitha furnizimeve dhe pajisjeve të furnizuesit, që janë të nevojshme për qëllime të kontratës.

21.5 Dorëzimi duhet të konsiderohet se është bërë atëherë kur ka dëshmi me shkrim që është në dispozicion për të dy palët se dorëzimi i furnizimeve është bërë në pajtim me kushtet e kontratës.

Neni 22 Operacionet e verifikimit

22.1 Furnizimet nuk do të pranohen derisa të jenë realizuar verifikimet dhe testet e caktuara me shpenzime të Furnizuesit. Inspektimet dhe testet mund të realizohen para transportit, në pikën e dorëzimit dhe/ose në destinimin final të mallrave.

22.2 Autoriteti kontraktues, gjatë progresit të dorëzimit të furnizimeve dhe para se të merren furnizimet, duhet të ketë fuqinë që të urdhërojë ose të vendosë:

- a) heqjen nga vendi i pranimit, brenda asaj kohe ose kohësh siç është specifikuar në urdhër, të të gjitha furnizimeve të cilat, sipas mendimit të autoritetit kontraktues, nuk janë në pajtim me kontratën;
- b) zëvendësimin e tyre me furnizime të mira dhe të përshtatshme;
- c) heqjen dhe ri-instalimin e mirë të pajisjeve, pa marrë parasysh testet e mëparshme të tyre ose pagesat e pjeshme të tyre, ose ndonjë instalim që lidhet me materialet, mjeshtërinë ose dizajnin për të cilin është përgjegjës furnizuesi, e që sipas mendimit të autoritetit kontraktues nuk është në pajtim me kontratën;
- d) që puna e bërë ose mallrat e dorëzuara apo materialet e përdorura nga furnizuesi janë ose nuk janë në pajtim me kontratën, ose që furnizimet apo një pjesë e tyre nuk i plotësojnë kërkesat e kontratës.

22.3 Furnizuesi, sa më shpejt që është e mundur dhe me shpenzime të veta, duhet t'i evitojë defektet e specifikuar. Nëse Furnizuesi nuk vepron sipas këtyre urdhrave, Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të punësojë persona tjerë për t'i zbatuar urdhrat dhe të gjitha shpenzimet që janë pasojë e kësaj, apo që do të shfaqen për shkak të kësaj, Autoriteti kontraktues do t'i zbrësë nga paratë që do të paguhen ose të cilat do të bëhen obligim për t'iu paguar Furnizuesit.

Neni 23 Pranimi i përkohshëm

23.1 Furnizimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të jenë dorëzuar në pajtim me kontratën, t'i kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet e kërkuara, dhe të jenë autorizuar, si dhe të jetë lëshuar një certifikatë e pranimit të përkohshëm ose nëse konsiderohet se është lëshuar.

23.2 Furnizuesi mund të bëjë kërkesë, duke lajmëruar autoritetin kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm atëherë kur furnizimet të jenë të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga pranimi i aplikacionit të furnizuesit do të veprojë sipas njëres nga këto më poshtë:

Neni 24 Obligimet për garanci

24.1 Furnizuesi do të garantojë që furnizimet të jenë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit dhe të përfshijë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe materiale, përveç nëse kërkohet ndryshe në kontratë. Furnizuesi do të garantojë që asnjë nga furnizimet të mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshtëria. Kjo garanci do të mbetet e vlefshme në atë mënyrë që saktësohet në KVK.

24.2 Furnizuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve në ndonjë pjesë të furnizimeve të cilat mund të paraqiten, apo të ndodhin gjatë periudhës së garancisë dhe të cilat:

a) rezultojnë nga përdorimi i materialeve defektive, mjeshtërisë së gabueshme ose dizajnit jo të mirë nga Furnizuesi; ose

b) rezultojnë nga veprimet ose mosveprimet e Furnizuesit gjatë periudhës së garancisë; ose

c) shfaqen gjatë ndonjë inspektimi të bërë nga Autoriteti kontraktues ose në emër të tij.

24.3 Furnizuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt që kjo të mund të praktikohet. Periudha e garancisë për të gjithë artikujt e ndërruar ose të riparuar do të fillojë përsëri nga data në të cilën është bërë ndërrimi ose riparimi sipas vlerësimit të autoritetit kontraktues. Periudha e garancisë do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të furnizimeve që është ndikuar nga ndërrimi apo riparimi.

24.4 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së garancisë, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë k Furnizuesin. Nëse Furnizuesi nuk arrin ta kompensojë dëmin nga ndonjë defekt ose një dëm brenda afatit kohor të paraparë në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

a) të korrigjojë defektin apo dëmin vetë, ose të punësojë dikë tjetër për ta bërë punën në rrezikun dhe me shpenzimet e Furnizuesit, në të cilin rast kostoja e shkakuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga paratë që duhet të paguhet ose garancitë që mbahen prej Furnizuesit ose nga të dy;

b) në rast se nuk ka sasi të duhur ose asnjë garanci nuk është efektive kërkoni që të merrni shumën e duhur nga Furnizuesi; ose

c) të ndërpresë kontratën.

24.5 Obligimet e mirëmbajtjes do të parashihen në KVK dhe në specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së garancisë nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e garancisë do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 25 Shërbimet pas-shitjes

25.1 Shërbimet pas-shitjes, nëse kërkohen në kontratë, do të jepen në pajtim me të dhënat e parapara në KVK. Furnizuesi do të marrë përsipër të realizojë ose të organizojë realizimin e mirëmbajtjes dhe të riparimit të furnizimeve dhe të sigurojë shpejt pjesët rezervë. KVK mund të saktësojnë që Furnizuesi të sigurojë ndonjë ose të gjitha materialet e mëposhtme, njoftimet dhe dokumentet që kanë të bëjnë me pjesët rezervë që i prodhon apo i distribuon Furnizuesi:

a) pjesët rezervë të cilat Autoriteti kontraktues mund të vendosë t'i blejë nga Furnizuesi, duke kuptuar që ky vendim nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e garancisë sipas kontratës

b) në rast të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve rezervë, duhet të lajmërohet paraprakisht Autoriteti kontraktues për t'i mundësuar që të blejë pjesët e kërkuara dhe, pas ndërprerjes, skicat, vizatimet dhe specifikimet e pjesëve rezervë, nëse kërkohen dhe kur kërkohen do t'i sigurohen Autoriteti kontraktues pa pagesë.

Neni 26 Pranimi përfundimtar

26.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Titulli: Furnizim me material të imët dhe paisje teknike për nevojat e të gjitha njërive shpenzuese Nr. Prokurimit-brendshem: VI657-20-002-121

Furnizuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Furnizuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata finale e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 24 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

26.2 Kontrata nuk do të konsiderohet se është realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit ose derisa të konsiderohet se kjo është nënshkruar nga autoriteti kontraktues.

26.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Furnizuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Neni 27 Shkelja e kontratës

27.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

27.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

27.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

27.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Furnizuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 28 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

28.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Furnizuesit 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- a) kur Furnizuesi në mënyrë përmbytëse nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;
- b) Furnizuesi dështon në përmbytëse brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të punëve;
- c) Furnizuesi refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- d) Furnizuesi ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- e) Furnizuesi falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- f) Furnizuesi është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- g) Furnizuesi është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetojë Autoriteti kontraktues;
- h) Furnizuesi i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat financiare të Komuniteteve;
- i) Furnizuesi, pas një procedure tjetër të prokurimit ose procedure të dhënies së një granti të financuar nga buxheti i komunitetit, është deklaruar se ka bërë shkelje serioze të kontratës për mosrealizim të obligimeve të veta kontraktuese;

j) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Furnizuesit, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

k) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

l) Furnizuesi nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

Neni 29 Ndërprerja nga ana e Furnizuesit

29.1 Furnizuesi, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

- nuk arrin t'i paguajë Furnizuesit shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit.

- vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

- e pezullon dorëzimin e furnizimeve, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Furnizuesit.

29.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit.

29.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 29.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Furnizuesin për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Furnizuesit.

Neni 30 Forca madhore

30.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një *forcë madhore* që shkaktohet pas datës kur kontrata hyn në fuqi.

30.2 Për qëllime të këtij Neni, termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozionet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

30.3 Pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 16 dhe 28, Furnizuesi nuk do të jetë i detyruar të heqë dorë nga garancia e realizimit, dëmet e likuiduara ose ndërprerja për shkak të shkeljes nëse, dhe deri në atë masë sa, vonesa e tij e realizimit ose mënyrë tjetër dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Gjithashtu, pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 20.5 dhe 29, Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nga Furnizuesi për shkelje të kontratës, nëse dhe deri në atë masë sa vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

30.4 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga autoriteti kontraktues me shkrim,

30.5 Nëse Furnizuesi shkakton kosto plotësuese gjatë zbatimit të urdhrave të autoritetit kontraktues ose gjatë përdorimit të mjeteve alternative sipas nenit 30.4 shuma e saj do të certifikohet nga autoriteti kontraktues.

Neni 31 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

31.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

Titulli: Furnizim me material të imët dhe paisje teknike për nevojat e të gjitha njësive shpenzuese Nr. Prokurimit-brendshem: VI657-20-002-121

31.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes

Neni 32 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

32.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- ose vendim nga gjyqi; ose
- kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK..

32.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATËS KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Gjykatës themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje ekonomike
	2.2	Kontrata është për furnizimi të kohepaskoshme, sipas kërkesave të njesive shpenzuese dhe nevojave të tyre. OE duhet tu përgjigjet të gjitha njesive sepse ato kanë buxhet të ndarë, dhe përpilojnë kërkesat veç e veç
	2.4	
	2.5	Porosia të bëhet 48 orë më herët, ndërsa liferimi i mallrave të kryhet brenda 48 orë më së largu nga porosia
Cilësia e furnizimeve	18.2	<i>Malli duhet të jetë i cilësisë së garantuar. Mallrat nuk guxojnë të jenë me afat të skaduar, por skadencia të jetë së paku një vit.</i>
		<i>Sigurimi i ekzekutimit është 10 %, të shumës së kontratës</i> Shuma 1,955.00€
Inspektimi dhe testimi	19.2	Menaxher i kontratës Ekrem Shabani
Pagesa	20.1	Pagesat për furnizimin e kryer do të bëhen sipas faturave të furnizimit dhe urdhër blerjeve
Dorëzimi	21.3	Zyra e pranimit e komunes ne Viti

Titulli: Furnizim me material të imët dhe pajisje teknike për nevojat e të gjitha njesive shpenzuese Nr. Prokurimit-brendshëm: VI657-20-002-121

Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	Palet do te bejne te gjitha perpjekjet për te zgjidhur ne menyre miqsore te gjitha mosmarveshjet qe mund te ndodhin ne mes tyre sapo te shfaqet ndonje mosmarveshje , palet do te lajmrojne njera-tjetren me shkrim per poziten e tyre ne mosmarveshje dhe per ndonje zgjidhje qe ata konsiderojne se eshte e mundhme
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatës themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje ekonomike në pajtim me ligjin në Kosovë. ose</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [<i>specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)</i>]. Gjykatës themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje ekonomike</p>

PARAMASA E MATERJALIT TË IMËT DHE PAISJE TEKNIKE PËR TË GJITHA NJËSITË SHPENZUESE

Nr	Emertimi	Njësia	sasia	çmimi	Shuma
Materjal dhe paisje te vogla per rrymë					
1	Dana të rrymes	Copë	5	4.00	20.00
2	Fasanka të thjeshta	Copë	75	0.08	6.30
3	Fazamatës	Copë	10	0.58	5.78
4	Fleks elektrik I vogel ,cilsia mesatare	Copë	4	36.75	147.00
5	Aparat saldues 120A	Copë	2	121.20	242.40
6	Elektroda per saldim pako 100cope	pako	10	4.52	45.15
7	Gips 2.5kg	Copë	30	0.26	7.88
8	Kabell e rrymes 5x2.5 mm	metër	130	1.01	131.04
9	Kabell e rrymes 5x4 mm	metër	52	1.68	87.36
10	Kabell GG-J 5x16mm(fleksibil)	metër	50	7.14	357.00
11	Kabell e rrymes 3 x1.5mm	metër	150	0.39	58.28
12	Kabell e rrymes 3x2.5 mm e butë	metër	75	0.68	51.19
13	Kabell e rrymes 3 x2.5mm	metër	150	0.60	89.78
14	Kabell Vazhduese 3x2.5 gjatsi 5m me pesë porta	Copë	15	8.93	133.88
15	Kabell Vazhduese 3x2.5 gjatsi 5m me tri porta	Copë	10	6.83	68.25
16	Kabell Vazhduese 3x1.5 gjatsi 3m me tri porta	Copë	10	5.78	57.75
17	Kabell e rrymes 5 x1.5mm	metër	120	0.70	84.42
18	Kaqavida komplet prej 6 copave	Copë	3	6.00	18.00
19	Klimë 12, me montim,garancion 12 muaj	Copë	12	304.50	3,654.00
20	Kokoka të kabllos tre fazore	Copë	10	1.89	18.90
21	Nxems per termo 3.5 dhe 2.5	Copë	5	10.00	50.00
22	Ventilator per termo 3.5 dhe 2.5	Copë	5	12.00	60.00
23	Nxemse elektrike 2kw	Copë	2	25.00	50.00
24	Nxemse elektrike me vajë e brinjzuar 11-15 brinjë	Copë	5	35.00	175.00
25	Pomp zhytse per uje 1.1kw origjinale(prodhim italian)	Copë	10	168.00	1,680.00
26	Pomp zhytse per uje 2.5 kw origjinale(prodhim italian)	Copë	2	309.75	619.50
27	pompe uji e vogel(motorr)	Copë	2	89.25	178.50
28	Poqa te neonit ,gyp fluroscent p=1.8w ,1.2m	Copë	60	2.73	163.80
29	Poqa ekonomik 40w	Copë	100	1.37	136.50
30	Priza nje fazore montimi mbi mure	Copë	20	1.05	21.00
31	Priza nje fazore montimi në mure	Copë	20	1.05	21.00
32	Izolir I rrymes kualitet I larte 50m	Copë	20	0.63	12.60
33	Shpues elektrik (burmashin) cilsia mesatare	Copë	2	57.75	115.50
34	siguresa te rrymes automatike (16A,20A)	Copë	30	2.15	64.58
35	Sklopka te rrymes 4/6 (FID)	Copë	5	23.10	115.50
36	Spina një fazore mashkullore dhe femrore	Copë	25	3.15	78.75
37	Startera për drita të neonit	Copë	50	0.26	13.13

6.00

5.80

45.20

7.80

131.30

28.50

51.00

90

133.88

68.25

57.75

178.00

84.42

18.00

3,654.00

18.90

50.00

60.00

50.00

175.00

1,680.00

619.50

178.50

163.80

136.50

21.00

21.00

12.60

115.50

64.58

115.50

78.75

13.13



38	Koke e rrymes qe e redukton rrymen nga trifazore në njëfazore	Copë	5	4.20	21.00	
39	KONTAKTE PËR LIDHJE (Vago klerne) ME 5dhe 3 VRIMA	Copë	10	0.16	1.58	1.60
40	ZILE ELEKTRIKE	Copë	5	1.37	6.83	6.85
41	KK-sh (KPO) So-1 POLIESTER	Copë	2	12.60	25.20	
42	BRISK PËR ZHVESHJEN E KABLOS	Copë	3	7.35	22.05	
43	FIJE PËRQUESE P/F 1x1.5mm²	metër	120	0.14	16.38	16.80
44	INDIKATORË PËR BANJO	Copë	5	8.40	42.00	
45	PRIZA ELEKTRIKE TRIFAZORE OG	Copë	10	3.15	31.50	
46	MBAJTËSE KABILLORE NJËFISHE	Copë	10	3.50	35.00	
47	RELE AUTOMATIKE E SHKALLËVE	Copë	8	14.70	117.60	
48	Thithse elektrike e madhe per institucione	Copë	6	78.00	468.00	
49	Pegull per hekurosje per institucione	Copë	3	15.00	45.00	
50	Diska për prerjen e hekurit (për fleks)	Copë	12	1.00	12.00	
51	Furnizim me amonjak dhe mbushja e klimave	Liter	50	2.50	125.00	
52	Riparimi i klimave	Copë	10	50.00	500.00	
Materjal dhe paisje per ujsjelles ,kanalizim ,Nxemje qendrore dhe të tjera						
53	Bateri Bojleri	Copë	2	35.00	70.00	
54	Brava për dyer druri dhe metalike me vend per cilindra kualiteti I lartë	Copë	75	2.31	173.25	
55	Brava per dyer plastike me vend per cilinder	Copë	5	1.47	7.35	
56	Cilinder per dyer të cilsis së lartë me 5 qelsa	Copë	75	2.10	157.50	
57	Dana per ujsjellës madhsi 2 coll	Copë	2	7.14	14.28	
58	Doreza pune	palë	30	0.71	21.42	21.30
59	D.nipple 3 x 4	Copë	10	0.74	7.35	7.40
60	D.nipple 6 x 1 coll	Copë	10	2.21	22.05	22.10
61	Dryna	Copë	5	1.61	8.03	8.05
62	Ek ventilla për ujsjellës të cilsisë së lartë 1/2	Copë	10	3.57	35.70	
63	Gjysmelidhese 1/2	Copë	10	1.16	11.55	11.60
64	Gjysmelidhse 1 coll	Copë	10	2.94	29.40	
65	Gjysmelidhse 3/4	Copë	20	2.21	44.10	44.20
66	Guac për wc nga porceloni (shole) komplet me kazan	Copë	2	72.45	144.90	
67	Guac për wc nga porceloni (shole) pa kazan	Copë	3	21.00	63.00	
68	Kapak per wc	Copë	10	3.68	36.75	36.80
69	Kazan per wc	Copë	3	12.60	37.80	
70	Elemente të brendshme te kazanit te wc komp	Copë	3	7.35	22.05	
71	Gyp per ujë 1/2	metër	100	0.32	31.50	32.00
72	Gyp per ujë 5/4	metër	100	0.89	89.25	89.00
73	Izolir teflon(trakë ngjitse)	Copë	50	0.63	31.50	
74	Korp per hidrofor	Copë	5	9.45	47.25	
75	Kos e dores per kositjen e barit	Copë	1	15.75	15.75	
76	Kos per kositjen e barit me benzin	Copë	4	99.75	399.00	
77	Kthes cu 28/28	Copë	10	1.00	10.00	
78	Lavabor per duar nga porcelani	Copë	2	19.95	39.90	



79	Llak pa ngjyre 1/1	Copë	3	3.15	9.45
80	Mbajtse per radiator 50x60 dhe 50x33	Copë	20	2.50	50.00
81	Muf cu 28/22/18/15	Copë	10	4.00	40.00
82	Nitro tretes 1/1	Copë	20	2.73	54.60
83	Pegell per gypa per PVC dhe gersheret	Copë	1	36.75	36.75
84	Qeshme lëvizëse 1/2 montimi mbi lavabor me dy lloje të ujit	Copë	5	14.70	73.50
85	Qeshme 1/2	Copë	10	4.10	40.95
86	Qeshme 3/4	Copë	10	5.99	59.85
87	Qetka fi 70	Copë	10	6.00	60.00
88	Qynga 0.5m	Copë	10	5.00	50.00
89	Qynga 1m	Copë	10	6.00	60.00
90	Qynga kthesë	Copë	10	6.00	60.00
91	Radiator 600/1000	Copë	5	54.60	273.00
92	Radiator 600/1200	Copë	5	65.10	325.50
93	Reduktues 6x1coll 3/4	Copë	10	1.89	18.90
94	Rezervuar per pomp 100l	Copë	3	75.60	226.80
95	Rezervuar per pomp 50l	Copë	3	38.85	116.55
96	Rezervuar per pomp 20l	Copë	3	17.85	53.55
97	Sifona per lavabor	Copë	10	1.58	15.75
98	Sopat me bisht 15kg	Copë	2	15.75	31.50
99	Stufa me shamot(Kamina)	Copë	2	150.00	300.00
100	Teshtik 3x4	Copë	10	1.37	13.65
101	Teshtik coll	Copë	10	2.00	19.95
102	Teshtik cu 28/28	Copë	5	2.50	12.50
103	Teshtik cu 28/28 22/22 15/15	Copë	10	2.50	25.00
104	Ventila per radiator l epern 1/2	Copë	10	3.57	35.70
105	Ventila per radiator l poshtem, 1/2	Copë	10	3.57	35.70
106	Ventila 1/2	Copë	10	2.63	26.25
107	Ventila 1coll	Copë	10	4.20	42.00
108	Ventila 3/4	Copë	10	2.73	27.30
109	KTHESA Cu 22	Copë	18	0.77	13.86
110	KTHESA Cu 18	Copë	20	0.40	7.98
111	KTHESA Cu 15	Copë	15	0.24	3.62
112	GJYSËM KTHESA Cu 15	Copë	15	0.24	3.62
113	TE Cu 22-22-22	Copë	4	1.26	5.04
114	TE Cu 22-15-22	Copë	8	1.05	8.40
115	TE Cu 18-18-18	Copë	10	0.98	9.77
116	TE Cu 18-15-18	Copë	20	1.05	21.00
117	TE Cu 15-15-15	Copë	20	0.49	9.87
118	MB 15	Copë	20	0.53	10.50
119	MS 22	Copë	20	1.16	23.10
120	REDUKTUES 3/4-1/2 (Filetë mbrenda)	Copë	8	0.74	5.88
121	REDUKTUES 1"-3/4	Copë	8	1.26	10.08
122	MUF 3/4	Copë	10	0.89	8.93
123	MBAJTËSE GYPASH Ø 22	Copë	20	0.32	6.30
124	MBAJTËSE GYPASH Ø 18	Copë	30	0.21	6.30

41.0
59.90

15.80

13.70

20

26.30

13.86

8.00

3.10

2.60

9.80

9.80

10.60

23.20

5.92

8.90

6.40



125	MBAJTËSE GYPASH Ø 15	Copë	50	0.16	7.88
126	SHTRAFJA+TIPLLA Ø 8	Copë	100	0.15	15.00
127	SHTRAFJA+TIPLLA Ø 10	Copë	50	0.15	7.50
128	KALLAJ+PASTË+MAP GAS	Copë	5	15.00	75.00
129	GYP 16 (Bozhur)- KUQ-KALTËRT	metër	100	0.68	68.25
130	EK LIDHËSE 16 (1/2)- Plastikë + Zingtuar F	Copë	10	1.05	10.50
131	EK LIDHËSE 22 (3/4)- Plastikë + Zingtuar F	Copë	10	1.68	16.80
132	EK LIDHËSE 16 - Plastikë + Zingtuar M	Copë	10	1.68	16.80
133	EK LIDHËSE 22 (3/4)- Plastikë + Zingtuar M	Copë	10	2.21	22.05
134	VAZHDIUES 3/4 - Plastikë + Zingtuar	Copë	10	2.10	21.00
135	REDUKTUES 3/4-1/2 - Plastikë + Zingtuar	Copë	10	0.06	0.63
136	VAZHDIUES 1/2 - Plastikë + Zingtuar	Copë	10	1.47	14.70
137	T-LIDHËSE 3/4 - Plastikë + Zingtuar	Copë	10	0.16	1.58
138	T-LIDHËSE 15 - Plastikë + Zingtuar	Copë	10	0.08	0.84
139	GYP 1/2 Zingtuar	metër	30	2.43	72.77
140	GYP 3/4 Zingtuar	metër	30	2.43	72.77
141	GYP Ø100 6x250 mm	Copë	5	2.00	9.98
142	GYP Ø100 6x500 mm	Copë	5	3.05	15.23
143	KTHESA Ø100 90°	Copë	10	2.94	29.40
144	KTHESA Ø100 45°	Copë	10	2.95	29.51
145	KTHESA-Y Ø100x100	Copë	4	4.73	18.90
146	KTHESA-Y Ø100x50	Copë	5	2.73	13.65
147	KTHESA-Y Ø50x50	Copë	4	0.89	3.57
148	GYP Ø50 10x500 mm	Copë	5	1.26	6.30
149	GYP Ø50 10x1000mm	Copë	5	2.10	10.50
150	GYP Ø50 10x250mm	Copë	5	0.89	4.46
151	MUFA Ø100	Copë	5	2.31	11.55
152	MUFA Ø50	Copë	6	0.68	4.10
153	REDUKTUES nga Ø100 në 50	Copë	6	0.68	4.10
154	KTHESA nga Ø50° në 90°	Copë	20	0.37	7.35
155	KTHESA nga Ø50° në 45°	Copë	10	0.37	3.68
156	GJYSËM LIDHËSE 16 ME FILET JASHT	Copë	20	1.16	23.10
157	GJYSËM LIDHËSE 16 ME FILET MBRENDIA	Copë	20	1.16	23.10
158	GYPA FLEKSIBIL 16	Copë	20	0.68	13.65
159	Lidhëse Ø90 Roming	Copë	6	4.00	24.00
160	Lidhëse Ø150 Roming	Copë	6	5.00	30.00
161	Lidhëse Ø200 Roming	Copë	6	7.00	42.00
162	Lidhëse Ø90	Copë	6	3.00	18.00
163	Lidhëse Ø150	Copë	6	5.00	30.00
164	Lidhëse Ø200	Copë	6	6.00	36.00
165	Elektroda ø2.5, ø3.0	Pako	10	4.50	45.00
166	Gypa te metalit 20x20x1.5mm, 20x30x1.5mm, 20x40x1.5mm	cope	16	5.46	87.36
167	Gyp metalik I zinkuar	Copë	5	5.00	25.00

8.00
68.00
22.10
0.60
1.60
0.80
72.90
72.90
10.00
15.25
29.50
18.92
3.56
4.45
4.08
4.08
7.40
3.70
23.20
23.20
13.60



168	Bojler I vogel 10 l	Copë	3	47.25	141.75
169	Tel shalloni	Kg	24	2.00	48.00
170	Pompa per nxemje qendrore madhsi të ndryshme	cope	5	50.40	252.00
171	Ventilla thikë dimenzione të ndryshme	cope	5	6.00	30.00
172	Ventilla holander sferik	cope	5	3.10	15.49
173	Makinë pastruese për dysheme (pllaka) si në foto, me dy funksione, larje dhe terje, prodhim BE	cope	4	960.00	3,840.00
Gjithsej					19,548.08

15,50



19.551.29

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	N.P.SH " ONI design"
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TE OE:	Ilir Sadiku
DATA:	24.06.2020
NËNSHKRIMI:	<i>Ilir Sadiku</i>
VULA:	



verifikuar:

- 1 *[Signature]*
- 2 *[Signature]*
- 3 *[Signature]*

	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo Komuna e Vitisë Opstina Vitina-Municipality of Vitina</p>	
<p>ZYRA E KRYETARIT KANCELARIJA PRESEDNIKA - PRESIDENT'S OFFICE</p>		

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr 03/L-040 (Gazeta zyrtare nr 28/2008) dhe nenit 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë 02 nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë, bien këtë:

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E MENAXHERIT PËR MBIKËQYRJEN E FURNIZIMEVE SIPAS KONTRATËS: **Furnizim me material të imët dhe paisje teknike për nevojat e të gjitha njësisve shpenzuese**

I.

Ekrem Shabani, CAKTOHET menaxher i projektit për kontratës: **Furnizim me material të imët dhe paisje teknike për nevojat e të gjitha njësisve shpenzuese**
VI657-20-002-121

I

Menaxheri nga neni 1 i këtij vendimi ka për detyrë që të bëjë:

- Menaxhimin e furnizimit të AK, të menaxhoj obligimet e AK sipas kontratës dhe të siguroj se OE kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar,
- Të siguroj kontroll të kostove, cilësisë dhe sasisë dhe kohën e dërgesave (vonesave),
- Të siguroj arritjen e qëllimit të kontratës, fushëveprimit, spicifikacionit dhe përgjegjësisë të AK dhe Furnizuesit.
- Të dorëzoj Planin e menaxhimit të kontratës dhe monitoron kontratën nga nënshkrimi deri në skadimin e saj.
- Të monitoroj/pranoj furnizimet dhe pagesat e kryera nga kompania

III.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Vitisë dhe menaxheri nga neni 1 i këtij vendimi.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Menaxherit,
2. Operatorit,
3. Zyrës së Prokurimit,
4. Arkivit

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË
Sokol HALITI

